



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. 2019

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 38, datë 06.06.2019

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 13/3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (në vijim "LPP"), në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Baftjar Murati", nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimeve publike, për *mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, brenda afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit*, në procedurën e prokurimit me objekt: "Rrethim i çerdhës dhe Qendrës Shëndetësore Metallaj, N.J.A.Maminas", të zhvilluar nga AK në datë 04.03.2019.

I. Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "Baftjar Murati", me NIPT L51322024A, me adresë: Rruga "Mantho Nakuçi", Godina Nr. 28, Tiranë.

II. Arsytet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Baftjar Murati", ka nisur mbi bazën e kërkesës Nr. 1005 Prot., datë 20.03.2019, të dërguar nga Bashkia Shijak, me të cilën kjo e fundit i propozon APP-së nisjen e hetimit administrativ ndaj operatorit ekonomik "Baftjar Murati", për përjashtimin e tij nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, në zbatim të nenit 13/3/ç të LPP.

III. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e *mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, brenda afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit*, sipas parashikimeve të nenit 13/3/ç të LPP.

IV. Masat:

Me Vendimin Nr. 38, datë 06.06.2019, APP ka vendosur të përjashtojë për 1 (një) vit operatorin ekonomik "Baftjar Murati", nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pasi ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese faktin që, operatorit ekonomik "Baftjar Murati", nuk ka precedentë të mëparshëm për përjashtim nga pjesëmarrja në prokurimet publike, si dhe vlerën e vogël të kontratës së nënshkruar me objekt: "Rrethim i çerdhës dhe Qendrës Shëndetësore Metallaj, N.J.A.Maminas", prej 593.305 (pesëqind nëntëdhjetë e tre mijë treqind e pesë) lekë me TVSH.